

## Tregu i Bashkimit European dhe kërkesat e tij për eksportin e mallrave

Në ekonominë botërore, politika tregtare e Europës duhet të bëhet një pjesë integrale e përpjekjes së saj më të gjerë ndaj reformave ekonomike dhe konkurrueshmërisë. Për të ndërtuar një ekonomi europiane më të fortë, Europa duhet të jetë më konkurruese jashtë saj.

Tregtia ndërkombëtare është pjesë kryesore e kësaj. Krahasuar me madhësinë e saj, BE është një nga ekonomitë më shumë të orientuara jashtë në botë. Tregtia europiane në mallra dhe shërbime zë rreth 15% të GDP së BE. Kjo është 3 pikë mbi SHBA dhe Japoninë. BE është eksportuesi i parë i mallrave dhe shërbimeve dhe investitori i parë jashtë.

Ashtu sikurse Tregu i Vetëm European, hapja e BE në tregti dhe investime ka qënë katalizatori kryesor i rritjes përgjatë 2 dekadave të fundit.

## KERKESA TE PERGJITHSHME TE TREGUT TE BASHKIMIT EUROPIAN

1. Fatura tregtare
2. Dokumentet e transportit (e ngarkesës)
3. Lista e paketimit
4. Deklarata e vlerës doganore
5. Siguracioni në udhëtim
6. Dokumenti i vetëm administrativ

### 1. Fatura tregtare

Fatura tregtare është një regjistër apo një evidencë e transkasionit ndërmjet eksportuesit dhe importuesit. Kur mallrat janë gati, eksportuesi lëshon një faturë tregtare për importuesin me qëllim që ta faturojë atë për mallrat.

Fatura tregtare përmban informacionin bazë mbi transkasionin dhe kërkohet gjithmonë për lejen doganore.

Të dhënat e përgjithshme janë si më poshtë:

- Informacion mbi eksportuesin dhe importuesin (emri dhe adresa)
- Data e lëshimit
- Numri i faturës

- Përshkrimi i mallrave (emri, cilësia etj)
- Njësia e matjes
- Sasia a mallrave
- Vlera për njësi
- Vlera totale
- Vlera totale e faturës dhe monedha e pagesës.
- Termat e pagesës (metoda dhe data e pagesës etj)
- Termat e dërgesës
- Mjetet e transportit

Nuk kërkohet formë specifike. Fatura tregtare përgatitet nga eksportuesi sipas praktikës standarte të biznesit dhe origjinali duhet të dërgohet me të paktën një kopje origjinale.

## 2. Dokumentet e Transportit (të ngarkesës)

Në varësi të mjetit të transportit të përdorur, dokumentet e mëposhtme duhet të plotësohen dhe ti paraqiten autoriteteve doganore vendit anëtar importues të BE mbi importin me qëllim të mallrave që do të deklarohen:

- Fatura e ngarkimit
- Fatura e ngarkimit FIATA
- Faturë shoqëruese malli (CMR)
- Libri ATA
- Libri TIR

### Fatura e ngarkimit

Fatura e ngarkimit (B/L) është një document i lëshuar nga kompania transportuese detare për transportuesin e mallrave i cili pranon që mallrat janë ngarkuar në bord. Në këtë mënyrë, fatura e ngarkimit shërben si provë e marrjes së mallrave nga agjencia transportuese duke e detyruar atë që ti dërgojë mallrat tek marrësi i ngarkesës.

### Fatura shoqëruese e mallit (CMR)

Fatura shoqëruese e mallit është një dokument që përmban detajet e transportit ndërkombëtar të mallrave nëpërmjet tokës. Ky dokument i jep mundësi dërguesit për ti patur mallrat në dispozicion gjatë transportit. Ky dokument duhet lëshuar në 4 dublikata dhe të firmosura nga dërguesi dhe

kompania transportuese. Kopja e parë i jepet dërguesit, e dyta mbetet në zotërim të kompanisë transportuese, e treta shoqëron mallrat dhe i dërgohet marrësit dhe e katërta duhet të firmoset dhe të vuloset nga marrësi dhe ti kthehet dërguesit. Zakonisht lëshohet një CMR për cdo kamion.

## Libri ATA

Libri ATA (Admission Temporaire/Temporary Admission) janë dokumente doganorë ndërkombëtarë të lëshuara nga Dhomat e Tregtisë në pjesën më të madhe të botës së industrializuar për të lejuar importin e përkohshëm e mallrave, pa taksa dhe tarifa doganore.

## Libri TIR

Libri TIR janë dokumente doganore transit që përdoren për transportin ndërkombëtar të mallrave, një pjesë e të cilit duhet të bëhet nëpërmjet tokës (rrugë). Sistemi TIR kërkon që mallrat të udhëtojnë në mjete transporti ose kontenerë të sigurtë, të gjitha taksat dhe detyrimet me risk përgjatë udhëtimit të mbulohen nga një garanci e vlefshme ndërkombëtare.

## 3. Lista e paketimit

Lista e paketimit (P/L) është një dokument tregtar që shoqëron faturën tregtare dhe dokumentet e transportit. Ajo jep informacion mbi njësitë e importuara dhe detajet e paketimit për secilën ngarkesë (pesha, përmasat, mënyrën e lëvizjes etj)

Të dhënat e përgjithshme janë:

- Informacion mbi eksportuesin, importuesin dhe kompaninë e transportit
- Data e lëshimit
- Numri i faturës së transportit
- Tipi i paketimit (kuti, arkë, cantë etj)
- Numri i paketimeve
- Përmbajtja e secilit paketim (përshkrim i mallrave dhe numri i njësive për paketim)
- Shënime dhe numrat
- Pesha neto dhe bruto dhe masat e paketimeve

Nuk kërkohet formë specifike. Lista e paketimit përgatitet nga eksportuesi sipas praktikës standarte të biznesit dhe origjinali duhet të dërgohet me të paktën një kopje origjinale.

#### 4. Deklarata e vlerës doganore

Deklarata e vlerës doganore është një dokument i cili duhet të paraqitet autoriteteve doganore kur vlera e mallrave të importuara e kalon vlerën EUR 10 000. Deklarata e vlerës doganore duhet të hartohet sipas formularit DV 1. Ky formular duhet të paraqitet me Dokumentin e vetëm administrativ.

Qëllimi kryesor i kësaj kërkesë është të caktojë vlerën e transaksionit me qëllim për të vendosur vlerën e doganës (vlerën e taksueshme) për të aplikuar detyrimet tarifore.

Vlera doganore i korrespondon vlerës së mallrave duke përfshirë kostot që rrjedhin (p.sh cmimin tregtar, transportin, siguracionin) deri tek pika e parë e hyrjes në Bashkimin Europian. Metoda e zakonshme për të vendosur Vlerën Doganore është duke përdorur vlerën e transaksionit (cmimi i paguar ose i pagueshëm për mallrat e importuara)

#### 5. Siguracioni në udhëtim

Siguracioni është një marrëveshje nëpërmjet së cilës i siguruari cdëmtohet në rastin e dëmtimeve të shkaktuara nga një rrezik të mbuluara në policën e sigurimit. Siguracioni është i rëndësishëm në transportin e mallrave për shkak të ekspozimit të tyre ndaj më shumë rreziqeve të zakonshme gjatë mbajtjes, magazinimit, transportimit por gjithashtu ndaj rreziqeve të tjerë të rrallë sic janë trazirat, sulmet apo terrorizmi.

Fatura e siguracionit kërkohet për lejen doganore vetëm kur të dhenat nuk duken në faturën tregtare për të treguar premiumin e paguar për të siguruar mallin.

#### 6. Deklarata e Importit Doganor (SAD)

Të gjitha mallrat e importuara në Bashkimin Europian duhet të deklarohen tek autoritete doganore të shtetit anëtar respektiv duke përdorur **Dokumentin e Vetëm Administrativ** (SAD), i cili është forma e zakonshme e deklaratës së për të gjithë Shtetet Anëtare.

- Deklarata duhet të hartohet në një prej gjuhëve zyrtare të BE e cila është e pranueshme nga autoritetet doganore të Shteteve Anëtare ku behën formalitetet.

Informacioni kryesor që duhet të deklarohet është:

- Të dhënat identifikuese të palëve të përfshira në operacion (importuesi, eksportuesi, përfaqësuesi etj)

- Traktati i aprovuar i doganave (deklarata për qarkullim të lirë, deklarata për konsumin, importin e përkoshëm, tranzitin etj)
- Të dhëna identifikuese të mallrave (kodi Taric , pesha, njësia), vendndodhja dhe paketimi
- Informacion që i referohet mjeteve të transportit
- Të dhëna për vendin e origjinës, vendin e eksportit dhe destinacioni
- Informacion tregtar dhe financiar (Incoterms, vlera e faturës, monedha e faturës, kursi i këmbimit, siguracioni etj)
- Lista e dokumenteve që lidhen me SAD (licensat e importit, certifikatat e inspektimit, dokumentet e origjinës, dokumentet e transportit, faturën tregtare etj)
- Deklaratën dhe mënyrën e pagesës së taksave të importit

Dhoma e Fasonistëve të Shqipërisë

Mars 2012